



KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË
SKUPŠTINA OPŠTINE - SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA



PROGESVERBAL VII/2024

I mbajtur me rastin e mbledhjes së 7 (shtatë) për vitin 2024 të Kuvendit të Komunës së Suharekës

Vendi: Suharekë
Zyra: Salla e Kuvendit të Komunës
Data: 22.07.2024
Ora: 10.00

Prezentë në takim:

Z. Shefket Kolgeci
Z.Selman Kolgeci
Z. Flamur Bytyqi
Z. Urim Suka
Z. Kushtrim Kuçi
Znj. Elmaze Bytyqi
Znj. Bulëza Kuçi
Znj.Doruntina Zenelaj
Z.Alban Berisha
z.Xhevshet Gashi
Z. Bexhet Kuçi
Z. Reshat Selimaj
Z. Lirim Qatani
Z. Aziz Bytyqi
Znj.Sanie Kuçi-
Rexhepaj
Znj.Fidaije Kukaj

Znj. Afërdita Morina
Z. Vullnet Luzhnica
Z.Edon Sadikaj
Znj.Saranda
Bajraktari
Znj.Mimoza Bajraktari
Znj.Festë Kabashi
Z.Dardan Berisha
Z.Bajram Basha
Znj.Mevlude Kabashi
Znj.Sheqerije Zyrapi
Znj.Laureta Tafaj
Z.Liridon Fandaj
Z.Qëndrim Elshani
Z.Herolind Limaj
Znj.Jehona Lumi-
Rrafshi

Të pranishëm të tjerë

**Kryetari Komunës
Media dhe qytetarë
OSCE, LMT, KDI
Znj.Habibe Bytyqi
Z.Xheladin Sadikaj**

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Asamblesë Komunale z.Bexhet Kuçi,i cili propozoi këtë:

REND DITE

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;**
- 3. Informatë për administrimin e buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën janar-qershor 2024;**
- 4. Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Suharekës për vitin 2023;**
- 5. Shqyrtimi i planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit nga zyra kombëtare e auditimit për vitin 2023;**
- 6. Informatë për aktivitetet e KKS-së për periudhën janar-qershor 2024;**
- 7. Raport nga DSHPJK për periudhën janar-qershor 2024 për çështjen e dhënies së pronave në shfrytëzim;**
- 8. Pyetje dhe përgjigje;**

Kryesuesi - përshëndet të pranishmit dhe thotë se është një kërkesë nga DSHPJK e cila kërkon që ta fus një pikë shtesë në rend dite dhe fjalën ia jep Drejtorit të Pronës.

Armend Krasniqi - përshëndet të pranishmit.Na ka ardhë një kërkesë nga AKP-ja ku na ka sjell një letër me disa prona të cilat kanë qenë duke u menaxhuar dhe na ka thënë që nese ne jemi të interesuar që ti marrim në pronësi dhe ti menaxhojmë.Na ka sjell rreth 12-13 prona të cilat kanë qenë në atë listë në komunën e Suharekës mirëpo për shkak të disa problemeve pronësore ne kemi vendos që ti vendosim vetëm 4 lokale dhe objekte që ti shpallim në interes të përgjithshëm.Drejtori tutje jep sqarime dhe thotë që ju ta kaloni në rend dite dhe pastaj të diskutohet.

Urim Suka - drejtori në shumicën e rasteve është i qartë por unë sot nuk e kuptova drejt për shkak që edhe nuk i kemi informatat.Ne nuk jemi për me pengu por dua ta pyes drejtorin.Ti the që kanë ardhë 12 prona nga AKP-ja dhe the që 4 i ke sjell me i lënë në pronësi të Komunës dhe të tjerat AKP-ja me i zhvillu në procedurat e veta.Pse vetëm 4 dhe të tjerat jo?Nëse ky vendim ka kohë,kisha thënë që më mirë të vje në procedurë të rregullt që ne me analizu secilën pronë dhe me ditë çfarë vendimi po marrim.

Armend Krasniqi - apsolutisht po sepse na ka ardhë me vonesë mirëpo të gjitha këto prona që i kemi analizu ne detaje na ka konstatuar që vetëm pronat që i kemi sjell sot në Asamble janë të rregullta dhe mund të shkojnë më tutje.Drejtori tutje jep sqarime dhe thotë që sa i përket kohës,nuk ka kohë sepse në shtator po mendon AKP-ja me i shpall në interes të përgjithshëm.

Kryesuesi - edhe unë e pata bisedë me drejtorin dhe e pyeta pikërisht për këtë por ky tha që janë të rregullune edhe qertifikatën e pronësisë dhe fletën poseduese dhe për këtë arsye e kemi sjell.

Armend Krasniqi - apsolutisht e kam sjell si mendim t'imin që e kemi analizu ne si DSHPJK.

Liridon Fandaj - përshëndet të pranishmit.Drejtor nëse vërtetë i ke analizu ato lokale,a ka ndonjë kontest tjetër? sepse ato lokale të paktën 20 herë kanë dal për me u dhënë me qera dhe dikush aty pretendon që janë të tyre dhe gjithmonë konkuron ai,e merr dhe kurrë nuk funksionojnë ato.

Armend Krasniqi - ato lokale ne i kemi analizu deri në detajin e fundit dhe kemi konstatuar së bashku me AKP-në që ato lokale janë të dhëna me qera nga AKP-ja dhe faktikisht ato menaxhohen nga AKP-ja dhe nuk ka paqartësi që ne e kemi has.

Kryetari - ju keni të drejtë por kërkesa na ka ardhë me vonesë.Rast konkret e kemi 25 Majin në fshatin Studenqan ku prona është komunale dhe objekti nuk ekziston.Nuk kemi ne çka me hy në procedura sepse s'kemi çka me ble.Procedurat e 25 Majit,të njejtat janë në Vraniq.Kryetari tutje jep sqarime.Mund ta fusni në rend dite por nuk është e thënë që mund ta kaloni.Mund ta shtyejmë edhe seancën e radhës por kjo seancë mbetet deri në fund të gushtit e pastaj kur të vje në fund të gushtit duhet me shku ligjshmëria 2 javë dhe deri në fund të shtatorit ne nuk kemi përgjigje dhe ky është qëllimi.

Urim Suka - vendimet që ne i marrim,secili prej tyre e ka rëndësinë e vet dhe për deri sa ne nuk e kemi informatën minimale për një çështje,ne normalisht e kemi vështirë me ngrit dorën për me përkrah një vendim.Ne si grup e apstenojmë si vendim.

Kryetari - a pajtoheni me ju sjell dokumentacionin dhe mbas 4-5 dite me mbajtë një seancë të jashtëzakonshme.

Kryesuesi - pasi u diskutua për pikën shtesë dhe mbetet që të vje në një seancë tjetër,unë e hedh në votim rendin e ditës pa pikën shtesë.

Unanimisht Miratohet rendi i ditës

Pika 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 1.

Unanimisht Miratohet pika 1.

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi - elaboron pikën dhe kërkon emrat nga subjektet politike për formimin e komisionit.

Aziz Bytyqi - ne propozojmë z. Edon Sadikaj.

Doruntina Zenelaj - ne propozojmë z. Flamur Bytyqi.

Bajram Basha - ne propozojmë z. Dardan Berisha.

Laureta Tafaj - ne nuk kemi propozim.

Jehona Rrafshi - nuk kemi propozim.

Herolind Limaj - nuk kemi propozim.

Kryesuesi - e hedh në votim propozimin për Edon Sadikaj.

18 për,8 apstenime

Kryesuesi - e hedh në votim propozimin për Flamur Bytyqin.

12 për,1 kundër,13 apstenime

Kryesuesi - e hedh në votim propozimin për Dardan Berisha.

16 për,10 apstenime

Pas numërimit të votave Kryesuesi konstaton që kalon Edon Sadikaj dhe Dardan Berisha.

Kryetari - nga ekzekutivi Besa Kuçi dhe Armend Krasniqi dhe nga shoqëria civile Erëza Muqa.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 2 për formimin e komisionit me këtë përbërje: Edon Sadikaj, Dardan Berisha, Besa Kuçi, Armend Krasniqi dhe Erëza Muqa.

18 për,8 kundër,Miratohet pika 2

Pika 3. Informatë për administrimin e buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën janar-qershor 2024;

Kryesuesi - i njofton me pikën dhe hap debatin.

Labiot Halitjaha - Drejtori për Ekonomi,Financa dhe Buxhet elaboron pikën.

Selman Kolgeci - ajo që vërtetë është e papranueshme është fakti se për 6 muaj nuk keni qenë në gjendje me shpenzu mbi 15% të buxhetit të ndara për investime kapitale dhe po krekoseni dhe po thoni që është më mirë se vitin e kaluar.Edhe vitin e kaluar dhe tash është keq dhe nëse krahasojmë ka shku gjysma e vitit kalendarik dhe nuk keni arrit as qerekun e mjeteve që janë nda për investime kapitale me i shpenzu. Janë mbi 50 projekte nga lista e investimeve kapitale nga investimet tjera që sipas kësaj informate që i është sjell Kuvendit,nuk është realizu asnjë investim në gjashtëmujorin e parë të këtij viti.Kjo është shqetësuese.A kemi me pas prap akrobacione të llojllojshme për me shpenzu buxhetin,me i rreziku zyrtarët dhe me nënshku diçka që në teren nuk është apo keni planifiku prap që një pjesë të buxhetit me qu në suficit qysh ka ndodh edhe në vitin 2023.As lista e prokurimit nuk po respektohet,as procedurat e prokurimit nuk po fillojnë e nuk po zhvillohen në përputhje me planifikimin e prokurimit për vitin 2024 siq edhe vet zyra e prokurimit ia ka dorëzu Kuvendit.Pavarësisht shpenzimit të ulët të buxhetit në investime kapitale,shuma e mejteve të cilat kanë shku për vendime gjyqësore është jashtëzakonisht e lartë.Janë mbi 1.700.000€ që kanë shku për gjashtë muaj në vendime gjyqësore.Kjo është një pasqyrë e paaftësisë dhe e papërgjegjësive së komunës.Kërkoj që të rritet aktiviteti dhe të zhvillohen procedurat e prokurimit sipas afateve të parapara dhe të kryhen investimet,të mos prolongohen punët në mënyrë që buxheti të shpenzohet sipas planifikimit.

Urim Suka - vërejtjet që ne i kemi thënë në vazhdimësi te shpenzimi i buxhetit edhe vitet e kaluara po e përcjellin këtë qeverisje edhe tash.Drejtori tha 15% ndërsa këtu në një tabelë te pasqyra përfundimtare investimet kapitale i kam 9.7 % që shkruan këtu.Sikur të jetë 9.7% ose 15% është një shumë relativisht e vogël duke e marrë për bazë që ju vet jeni krekos që nga viti i kaluar janë disa kontrata dy vjeqare të cilat kanë mund ta kenë një shpenzim të buxhetit edhe më të madh se që është tash.Koncentrimi i buxhetit tre muajt e fundit e lejon mundësinë për me pas keqpërdorime në fund.I dime vështirësitë që janë në tremujorin e parë dhe tremujorin e dytë mirëpo shifra prej 9% apo prej 15% janë të vogla dhe secili ekzekutiv është mirë me marrë me shqetësim një dukuri të tillë dhe me bo përpjekje maksimale që buxheti me u shpenzu më racionalisht për të gjitha periudhat kohore sepse kjo do ta mundësonte edhe rritjen e cilësisë së punime.

Fadil Hoxha - si ZKF jep sqarime sa i përket administrimit të buxhetit për vitin 2024 për periudhën janar-qershor.

Urim Suka - unë sa herë vi këtu,pa e lexu dokumentin nuk vi.E kam lexu në detaje dhe e kam edhe atë 26-tën që e përmende.Ju si staf ekzekutiv është mirë me u koordinu sepse ky tha 15% dhe po e marrë të mirëqen edhe atë 26% dhe te pjesëmarrja është 9 % dhe ju e keni shkru 9 %.Po e marrë këtë 26 % por prap për mua është gabim dhe është pak.Shqetësimi im është që mos e koncentroni krejt buxhetin tre muajt e fundit sepse pasojat po janë të mëdhaja dhe mbetejt.

Selman Kolgeci - sa % saktë është shpenzu buxheti i ndarë për gjashtëmujorin e parë për vitin 2024?Ndryshe e the ti,ndrysh e tha drejtori dhe ndryshe e thonë letrat. Kur po viktimizohesh për 1.7 milion,nuk duhet m'u viktimizu as ti e as ky tjetri këtu.Këtu iu kemi bënë thirrje para se m' u shkëput ajo kontrata kolektive që ta zbatoni kontratën kolektive sepse si pasojë e mos zbatimit të kontratës kolektive ne jemi duke pagu 50% shpenzime të avokatëve dhe përmbaruesëve dhe 50% po shkojnë për mësuesia. Nëse krejt janë të vërteta edhe 25 % nëse shkon investimi,janë 50 projekte që nuk i keni nis hiq.

Fadil Hoxha - treguesit e mi që janë realizu,janë të saktë.Drejtori ka thënë 15% është pjesëmarrja e përgjithshme që u nënkuptu sikur pjesë e shpenzimit.Sa është shpenzu buxheti për 6 muaj është në tabelën përfundimtare që është 58.4 % të gjitha llojet e kategorive ekonomike.Pra me shpenzimet e gjykatave dhe të tjerat dhe ky nuk është problem vetëm i komunës tonë por është problem vendor.

Selman Kolgeci - sa përqind e buxhetit të ndarë për gjashtë mujorin e parë janë shpenzu në investime kapitale pa bartje,pa grand?

Fadil Hoxha - buxheti i alokuar është 6.765.000 për të gjitha llojet e fondeve burimore,të shpenzuara janë 1.792.546 dhe kur pjestohet me këto del 26.5.

Liridon Fandaj - te pjesa që me vendim të gjykatës janë marrë,a deshte me u viktimizu apo si është puna? Sepse nëse ju nuk e keni planifiku që dikush mun me ia marrë me vendim të gjykatës ,atëherë është gabim.

Fadil Hoxha - nuk janë vendime që u desh me i zbatu komuna për m'i planifiku.Janë vendime të ish qeverive të kaluara që i kanë bërë me ministrinë e linjës dhe ata e kanë pas për obligim me ia vendos mjetet komunës sa ka me ardhë kjo pjesa për me iu pagu në mënyrë të rregullt por kjo nuk ka ndodh dhe borgji i ka mbet komunës.Është problem në nivel vendi.

Pika 4. Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Suharekës për vitin 2023;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Alban Berisha - a ka qenë ky raport për Asamblenë apo për Kuvendin Komunal?

Kryesuesi - raporti është për Komunën.

Alban Berisha - në rregull por s'ka nevojë me u elaboru prej teje.

Kryesuesi - e kam të drejtën me elaboru.

Alban Berisha - në rregull por dua ta dëgjoj prej Kryetarit.

Liridon Fandaj - para pak ditësh Kryetari Bali Muharremaj deklaroi që sipas ZKA-së komuna Suhareks ka menaxhuar mirë me pasqyra financiare.Këtë sqarim e jep Kryetari qysh e ka mendu por pasqyrat financiare nuk menaxhohen.Pas publikimit të raportit të ZKA-së kemi vërejtur se në raportin e auditimit të pasqyrave financiare për vitin 2023 janë 10 rekomandime.Prej tyre 3 rekomandime të reja,5 të përsëritura dhe 2 pjesërisht të përsëritura ku nga ky raport kemi vërejt se ka pas shkelje të natyrës së ndryshme.Sa i përket menaxhimit financiar dhe pajtueshmërisë si keqklasifikim i shpenzimeve në vlerë prej 168.369€ në kategori të ndryshme ekonomike si dhe prezantim jo të drejtë të llogarive të arkëtueshme në vlerë prej 20.562€,nga kjo vlen të theksohet se deklarata e Kryetarit të komunës nuk përkon me atë që është deklaruar në raport.Poashtu raporti i auditimit shihet se ka shkelje të shumta të ligjeve dhe rregulloreve.Po filloj prej pasaktësisë të regjistrimit të pasurisë,dhënies së subvencioneve jo në përputhje me thirrjet publike,zotimi i mjeteve jo në përputhje me rregullat financiare,mungesë e projekteve ekzekutive në realizim të punimeve,vonesa të shumta në realizimin e projekteve,mangësi në menaxhimin e të hyrave nga tatimi në pronë,vonesa në ekzekutimin e faturave,mungesa në raport të rregullt për shfrytëzimin e pronave komunale.Është viti i tretë që Kryetari asnjëherë nuk e ka marrë guximin me na sjell një raport për të gjitha pronat që shfrytëzohen dhe një ndër pikat që auditori e ka gjet është edhe kjo. E ka bërë një komision në zonë industriale prej fillimit të mandatit dhe sa herë kemi bërë pyetje,raporti nuk ka ardhë asnjëherë.Tani Kryetari i komunës së Suharekës dhe ish debuteti i Kuvendit të RKS-së nuk ka njohuri rreth raporteve të ZKA-së ose nuk i kupton ligjet dhe rregulloret të cilat përcaktojnë procedura dhe rregullat e shpenzimeve të parasë publike.Jo pa shkas e thashë ish deputeti i Kuvendit të RKS-së pasi ky vet ka qenë anëtarë i komisionit për Politikë dhe Financa.E nëse ky nuk i kupton pasqyrat financiare dhe nuk di si menaxhohen,atëherë vaj halli për tjerët që e udhëheqin komunën.

Urim Suka - kur jemi te raporti i auditimit të cilin po e analizojmë sot,më lejoni të theksoj që ky raport përgaditet në baza vjetore nga zyra kombëtare e auditimit si një organ i pavarur i cili auditon pasqyrat financiare vjetore të komunave të Kosovës.Kjo zyre në bazë të disa mostrave të cilat i përdor si dëshmi për të kryer auditimin vjen deri tek opinioni apo vlerësimi përfundimtar për pasqyrat financiare vjetore të komunës.Lidhur me këtë raport pushteti nuk ka pritur fare të diskutohet në kuvend e ta analizojmë bashkë por ka propaganduar si sukses të tij këtë raport e është krekosur për vlerësim pozitiv nga zyra kombëtare e auditimit mirëpo përkundër kësaj ky raport brenda saj ka 10 rekomandime,3 prej të cilave janë të reja ndërsa ajo që është e çuditshme është se 5 nga rekomandimet janë të përsëritura dhe 2 rekomandime pjesërisht të përsëritura.Kjo tregon për mungesën e përgjegjësisë e gaditshmërisë së këtij pushteti për implementimin e projekteve sipas procedurave e ligjeve në fuqi.Një nga gjetjet është se ju keni dhënë subvencione jo në përputhje me thirrjen publike që vet e keni bërë.Kjo gjetje është te drejtoria e Bujqësisë

por gjendja hiq më mirë nuk është edhe te Drejtoria e Kulturës e subvencione tjera ku janë dhënë. Unë ditë më pare jam njoftuar që kjo drejtori ka ndarë 7.000 € për botimin e një libri por libri nuk ishte botuar deri atëherë e besoj ende nuk është botuar ende. Është mirë të na sqaroni se si janë mbyllur raportet e përfundimit të punëve për subvencionet e dhëna. Ne duhet të dime që paratë që janë dhënë për subvencion, a kanë shkuar në destinacionin për të cilin janë dhënë. Ndërkohë ne jo vetëm që nuk e dimë fare se si janë realizuar këto aktivitete të subvencionuara por sipas raportit të auditimit po rezulton që këto subvencione janë dhënë edhe në kundërshtim me thirrjen publike në disa raste. Gjetje tjetër është edhe mungesa e projekteve ekzekutive. Pra në njërin anë kemi implementim të projekteve vetëm me paramasë dhe paralogari dhe nuk ka projekt ekzekutiv ndërsa kohën e fundit kemi parë në facebook Kryetarin që me një aparat kinse po bën matjen e cilësisë së punimeve. Kur jemi te cilësia e punimeve unë e mbështes secilën përpjekje të kujdo çoftë për të rritur cilësinë e punimeve mirëpo kjo tentativë e fundit me këto matje nuk e ka qëllimin për rritjen e cilësisë por qëllimi është tek mashtrimi i opinionit publik kinse angazhimi i këtij pushteti është te ngritja e cilësisë. Ku e kishe këtë aparat më herët? Pse nuk i bëje këto matje më herët? Kur jemi te cilësia e punimeve, këto ditë isha në Nishor, Breshanc e Kastërrc dhe i pash disa nga dëmtimet që ishin bërë në projektet që ju keni realizuar vitet e fundit. Tani ju ftoj të shkojmë bashkë e të shohim gjendjen e rrugës Breshanc e Kastërrc. Gjetje tjetër është edhe vonesa në realizimin e projekteve ku disa prej tyre i ka adresuar edhe zyra kombëtare e auditimit në këtë raport. Shqetësime të tilla kam ngritur në vazhdimësi por ju keni vazhduar duke thënë që kontratat janë dy vjeqare edhe pse aty figuronte një afat i caktuar për përfundimin e punimeve që binte ndesh me atë që ju thonit. Gjetjet e këtij raporti janë pothuaj asgjë nga gjendja në teren. Gjendja në teren është jashtëzakonisht shqetësuese se si janë bërë investimet në vitin 2023 por edhe në vitet tjera paraprake. Mirëpo duke marrë për bazë deklarin tuaj e krekosjen tuaj kinse raporti i auditimit është pozitiv, unë në KPF kam kërkuar një pikë të veçantë të rendit të ditës siç e kemi kërkuar disa herë për të formuar një komision nga të gjitha partitë për të parë se si janë realizuar projektet e listës së investimeve kapitale të miratuara nga ne por ju nuk pranuat në KPF ashtu siç nuk keni pranuar edhe më herët në këtë Kuvend që të zbardhet e vërteta për secilin investim e secilin projekt. Nëse ju po thoni që gjithëçka është mirë, e jani e bëjmë komisionin dhe e shohim se sa mirë jeni duke investu e sa mirë jeni duke qeverisë. Të dashur kuvendar e qytetarë, kritika jonë nuk është vetëm përmbushje e mandatit tonë opozitar por është edhe përpjekje për të ndryshuar këtë qasje të gabuar të këtij pushteti tash e sa vite. Andaj ju ftoj të na bashkoheni në këtë përpjekje e të luani rolin tuaj dhe ndikimin në rritjen e cilësisë dhe parandalimin e kësaj logjike të mbrapsht qeverisëse sepse jemi thellë të bindur që secili prej jush i dini problemet që ballafaqohemi çdo ditë.

Doruntina Zenelaj - përshëndet të pranishmit. Si çdo vit edhe këtë vit na ka ardhë raporti i auditimit ku në këtë raport kemi hasur në 10 rekomandime, ku 5 prej tyre janë të përsëritura, 3 të reja dhe 2 pjesërisht të përsëritura. Ato janë: Pasaktësimi në regjistrimin e pasurisë kapitale, dhënia e subvencioneve jo në përputhje me thirrjen publike, zotimi i mjeteve jo sipas rregulloreve financiare, mungesa e projektit ekzekutiv, vonesa në realizimin e projekteve, mangësi në menaxhimin e të hyrave nga tatimi në pronë, vonesa në ekzekutimin e pagesave të faturave, mangësi në raportimin e rregullt për shfrytëzim të pronave komunale, keqklasifikim i shpenzimeve dhe mbivlerësim i llogarive të arkëtueshme. Çështja

a.1 Pasaktësi në regjistrimin pasurisë kapitale: ky është një problem që përsëritet nga viti i kaluar. Ju ose nuk e keni marrë seriozisht këtë çështje apo rekomandim ose nuk keni marrë masa për përmirësimin e proceseve në regjistrimin e pasurisë nga zyrtarët kompetentë. Çështja a.2: Dhënia e subvencioneve jo në përputhje me thirrjen publike: siç është përmend në raport shpërndarja e subvencioneve jo në përputhje me thirrjen publike ndikon negativisht tek aplikuesit e tjerë për subvencionet tek të cilët i plotësojnë kushtet por nuk marrin subvencione. I kërkojmë Kryetarit që të shpalo emrat të cilët kanë marrë subvencione të pamerrituara në mënyrë që të mund të identifikojmë arsyet dhe lidhjet që ata persona mund të kenë me juve apo komisionin. Çështja b.1 Zotimi i mjeteve jo sipas rregullave financiare: keqpërdorimi i identifikuar në rastin e zotimit të mjeteve fillimisht duke pranuar faturat e pastaj duke bërë zotimin e mjeteve dhe urdhërblertjeve tregojnë më së miri parregullsitë që shfaqen në menaxhimin e projekteve. Ky keqmenaxhim ka ndodhur ose në mënyrë të qëllimshme për të favorizuar kontraktorët të cilët i konsideron të afërt me veten ose për shkak të keqmenaxhimit të projekteve. Çështja b.2 Mungesa e projektit ekzekutiv: iniciimi i procedurave të prokurimit, vetëm paramasa pa pasur një projekt konkret ekzekutiv, lë

hapësira që të ketë keqpërdorime në mbarvajtje të projektit duke mos përfunduar projekti sipas kriterëve të parapara me kohë dhe kjo nuk po ndodh për të favorizuar kompanitë pjesmarrëse në këto projekte.

Çështja b.4 Mangësi në menaxhimin e të hyrave nga tatimi në pronë: përsëritja e çështjes së mangësive në menaxhimin e të hyrave në pronë edhe këtë vit tregon që Kryetari jonë përveq që bën gabime, ai edhe nuk i përmirëson gabimet e veta që i vë në pah çdo herë në forma të ndryshme. **Çështja c.2** Mangësi në raportimin e rregullt për shfrytëzimin e pronave komunale: këto mangësi mund të kenë ndodhur në mënyrë të çëllimshme për të mbuluar ndonjë person të caktuar apo edhe për shkak të parregullsive apo përgjegjësisë në shfrytëzimin e këtyre pronave. **Çështja a.3** Keqklasifikim i shpenzimeve: keqklasifikimi i shpenzimeve rrezikon pozitën financiare të komunës duke mbivlerësuar apo nënvlerësuar kategoritë e ndryshme ekonomike dhe është në kundërshtim me rregullat financiare mbi shpenzimin e parasë publike. Katrahura e indentifikuar lë për të dëshiruar dhe pasqyron më së miri dëshirën e Kryetarit që të jetë zot i parasë dhe jo shërbyes i qytetarëve të komunës. Për çudi menaxhmenti është pajtuar në 10 gjetjet e këtij raporti që nënkupton që ata janë të vetëdijshëm për gabimet që kanë bërë e që kjo nënkupton se ato gabime janë bërë në mënyrë të qëllimshme.

Labiot Halitjaha - Selman dhe Urim ne nuk presim naj lavdatë prej juve sepse ju këtë punë e keni. Ne vitin e kaluar i kemi pas 17 rekomandime dhe tash i kemi 10 rekomandime. Ka përmirësim të mjaftueshëm në auditim. Urimi tha që gjendja në teren dhe letrat nuk janë asesi reale. Nuk po dimë kujt me i besu. A me të besu ty apo letrave. Ata janë një grup i pavarur që auditojnë krejt komunat e Kosovës.

Kryetari - unë nuk e kam plan me fol shumë por me punu shumë. Unë jam i stërkënaqur me auditimin dhe unë garoj këtë vit në top 5 për komunat më të mira në Kosovë. Ne këtë vit kemi një donacion më së paku mbi 1 milion euro. Është e vërtetë që kam qenë dy mandate në komision për mbikqyrjen e Financave Publike dhe e njoh këtë lami shumë mirë. 3 rekomandime i kemi të reja dhe çdo vit kemi me pas të reja.

Kur e kam marrë mandatin e Kryetarit, Komuna e Suharekës ka qenë e 26-ta në listë për performancë dhe sot ka mrri te top 5 i pare. Njerëz jemi dhe gjatë rrugës mund të bëjmë gabime. Te subvencionet, dy kompani që janë aty, të dyja i kanë mbi 100 ha tokë duke i punu dhe i kanë marrë në shfrytëzim.

Urim Suka - Po i besoj raportit dhe i lexova gjetjet e raportit. Gjetjet e raportit thonë që s'ke projekt ekzekutiv. Gjendja në teren, kam qenë e kam pa ku rrugët janë krejt të prishura për shkak se nuk ke cilësi. E kuptoj që është i kënaqur me raportin por gjendja në teren është tepër më e keqe se sa raporti. Ju lus asambleist ta lexoni faqen 5 se çka thotë për mënyrën se si janë menaxhu financat publike dhe mënyrën se si është bërë raporti. Gjetje të reja 3, në rregull por 7 janë përsëritje. Nëse po mendoni që raporti është mirë, hajde e formojmë komisionin dhe shkojmë i kqyrim një nga një. Kryetari nuk më dha përgjigje për aparatit për matjen e cilësisë.

Liridon Fandaj - dua të ndërlihem me drejtorin e Financave ku tha: nëse s'i besoni raportit. Ne i besojmë raportit dhe është agjension i pavarur por auditimi bëhet në bazë të mostrave dhe edhe në bazë të atyre mostrave nuk është që është raporti perfekt. Janë dy-tre mostra dhe nuk i ka marrë krejt investimet kapitale. Atë që po e thotë Urimi e kam thënë edhe në KPF por ju edhe raporti kur po vje, nuk po vini me u ballafaqu me atë që ne po i ngrisim. Nëse del në teren gjendja është shumë keq në krahasim me raportin.

Selman Kolgeci - sa i përket këtij raporti është se paaftësia e kësaj qeverisje tashmë po pasqyrohet në raporte zyrtare dhe për këtë duhet të jenë të përgjegjshëm e të ndërgjegjshëm para një opinionin të tillë si Kryetari dhe si drejtorët. Ky raport ka nxjerr 10 rekomandime nga e cila 3 janë të reja dhe 5 të përsëritura dhe 2 pjesërisht të përsëritura. Për nga mostrat që i ka përpunu ekipi i auditorve të jashtëm në 10 vende ka gjetur parregullsi, si: dhënie e subvencioneve duke mos i respektu kriteret që vet i kanë vendos, zotimi i mjeteve në kundërshtim me rregullat financiare, mungesë e projekteve dhe vonesave në realizimin e projekteve e shumë tjera. Këto të gjetura, ky rezultat, ky keqmenaxhim i shprehur në këtë raport ka të bëjë vetëm me lëndë të cilat janë punu si mostra. Nëse të gjitha lëndët iu kishin nënshtruar auditimit dhe numri i të gjeturave ish rrit për po aq sa lëndë i kish trajtu dhe me shumë gjasë Kryetari ose ndonjëri prej drejtorave nuk do të ishin në seancë. **Çështja b.2** Mungesa e projektit ekzekutiv. Në tre kontrata të testuara asnjëra nga to nuk është në mirëmbajtje. Vlera e këtyre kontratave është mbi 250.000€. Pra vetëm tre projekte i keni shpenzuar mbi 250.000€ me paramasa shabllon. Pash edhe një projekt tjetër në vlerë prej 300.000€ i cili ka qenë mostër e raportit të auditorit dhe është ekzekutu pa projekt dhe për çudi prej auditorit nuk është evidentu si kontratë që është realizu pa projekt. Kjo është e papërgjegjshme, nuk është e

drejt dhe ndikon negativisht në investime kapitale. Komuna jonë si institucion me këto praktika po jep shembullin më të keq të qytetarët sepse investimet po i bën pa projekt e që rrjedhimisht i bën investimet pa leje ndërtimore. Tek çështja b.3 vonesa në realizimin e projekteve. Në 6 projekte të trajtuara si mostra vlera e projekteve është mbi 1 milion €, në të 6 projektet kemi vonesa nga 60 ditë min. e deri në 1 vit max. në total. Dua ti besoj auditorit por çuditërisht auditori nuk ka tregu saktë se sa është dëmi që iu ka shkaktuar buxhetit të komunës në mosrealizimin e këtyre projekteve. Kemi thënë disa herë që jeni duke e dëmtuar buxhetin e komunës dhe po vazhdoni me dëmtu kur po përdorni procedurat e prokurimit me kriter për dhënien e tenderit ekonomikisht më të favorshëm. Çka i bie saktësisht kjo? Kjo i bie që ju po i ftoni kompanitë me konkuru në procedura të ndryshme edhe kur po poentoni rëndësinë më të madhe po e merr plani dinamik. Dmth kush zotohet që i kryen punën më shpejtë edhe pse e ka çmimin dhjetra mijë euro më të lartë se sa projektet tjera, ju prap po e zgjidhni atë operator i cili është zotu që ka me kry më shpejtë e si rezultat i kësaj po e shohim që 845 ditë vonesa në 6 projekte. Kjo është e papranueshme dhe nuk e di si krekoset Kryetari me raportin. Te kjo pikë auditori ka thënë: vonesat në realizimin e projekteve si rezultat i mungesës së mjeteve buxhetore dhe dinamikës së ulët gjatë kryerjes së punimeve ishin si shkak i mosrealizimit të projekteve sipas afateve të paracaktuara në kontratë. Mungesa e mjeteve tek kontratat me kriter për dhënie të tenderit ekonomikisht më i favorshëm, nuk mundesh me nis këtë procedure pa i pas krejt mjetet dhe këtë e dinë të gjithë. Për këto kontrata nuk mundet as Kryetari me arsyetu veten e as auditori nuk mundet me arsyetu Kryetarin dhe me thënë që s'ka pas mjete dhe për këtë janë vonu. Këto që përmban ky raport i demantojnë e i zhveshin prej popullizmit ato fotografitë e famshme me qizme të verdha, e ato fotografitë duke dreku nëpër livadhe e ato fotografi populliste duke deklaruar se të gjitha investimet në Suharekë do të bëhen me projekte e shumë akrobacione e popullizma të panevojshme të cilat i bën Kryetari Muharremaj për tu dukur që është i interesuar e i angazhuar.

Visar Kuçi - për mua, për gjithë drejtorat, për ekzekutivin është krenari që raporti i auditorit ka dalë mirë dhe rekomandimet nga 17 janë ulë në 10. Drejtori i Financave e tha që duhet me i besu auditorit sepse auditori është një organ i pavarur edhe pse ne si ekzekutiv në ato 10 gjetjet nuk jemi të kënaqur. Auditori ka thënë për një projekt që nuk ka projekt ekzekutiv. Për të njëjtën gjë ka pas konkurs të projektimit, ka pas dëgjim publik, ka leje ndërtimore por gjatë procedurave të prokurimit, zyra e prokurimit e ka shkru në dosje të tenderit që projekti mund të mirret në njësinë e kërkesës dhe auditori nuk e ka marrë parasysh këtë, përndryshe projekti ka qenë prej vitit 2020 ose ka naj projekt ku ka thënë ka vonesa kur publikisht nuk e dine veq Suhareka por e dinë e gjithë Kosova që rruga "Skënderbeu" është ndal me vendim të qeverisë dhe si pasoj ne si Komunë e kemi vuajt dhe kemi pas edhe humbje në buxhet të vitit të kaluar. Ka ardhë vendimi dhe kanë fillu punimet. Edhe atë ia kemi argumentu auditorit por nuk e ka pas parasysh. Gjetja tjetër te procedurat e pagesave, auditori vitin e kaluar na ka thënë që njëherë duhet me bë zotimin pastaj me pranuar faturën të menaxherat e kontratave dhe auditori ka bë si gjetje tash që një herë duhet të bëhet zotimi kur të vje situacioni, faturohet dhe procedohet dhe ne e pranojmë si gabim që vitin tjetër duhet me përmirësu. E mira që raporti i auditorit ka dalë mirë.

Selman Kolgeci - rrugën "Skënderbeu" nuk e ka përmend te mungesa e projekteve. Nëse gjatë punës së tyre ju ka thënë dhe pastaj ju ka hek, prap drejtor po du m'i besu auditorit por nuk është mirë.

Visar Kuçi - te vonesa e projekteve e thashë.

Selman Kolgeci - por megjithëatë ajo vetëm 60 ditë vonesa të projekteve përmban rr. "Skënderbeu" dhe 780 ditë të tjera nuk arsyetohen. Te çështja b.2 Mungesa e projekteve, ju jeni pajtu me atë që e ka gjet auditori dhe sot po na thoni ndryshe.

Visar Kuçi - pajtohem te projektet ekzekutive. Në vitin e kaluar kontrata e projektimit është vonu për shkak të OSHP-së. Këtë vit janë të gjitha me projekte sepse është kompania e kontraktune.

Pika 5. Shqyrtimi i planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit nga zyra kombëtare e auditimit për vitin 2023;

Kryesuesi - elaboron pikën dhe hap debatin.

Liridon Fandaj - plani i veprimit na ka ardhë si pikë shtesë në KPF dhe nuk e kemi diskutu. Në bazë të protokolimit të këtij plani me 11.07.2024, rekomandimet i kanë marrë me 30.06 ndërsa planifikimin e

zbatimit të këtyre rekomandimeve e kanë fillu në TM 2. Si mund ta bësh një plan të veprimit kur ti s' e ke raportin e auditimit. Një pjesë tjetër është në TM 4 në fund. Nëse ti edhe e fillon keq pa i pas rekomandimet dhe e vonon, nuk e di kush e ka bërë këtë plan të veprimit por nuk është në rregull.

Urim Suka- plani i veprimit nuk është vullnet që këta kanë dasht me bërë një plan me qëllim të përmirësimit për veten por është obligim që si ekzekutiv e kanë pas raportit të auditimit që vje. Plan i veprimit që e kemi miratu vitin e kaluar ka rezultu që 7 nga ato rekomandime që kanë qenë vjet, janë përsëritje. Problemi është që po mungon vullneti m'i bo senet sipas procedurave dhe ligjit dhe gjithë ajo zhurmë që u bë deri tash që ju po doni me na thënë: ju s'po i besoni raportit. Ne po i besojmë raportit por s'po ju besojmë juve dhe për me na nal neve, hajde e formojmë komisionin dhe një nga një shkojmë i kqyrim projektet.

Pika 6. Informatë për aktivitetet e KKS-së për periudhën janar-qershor 2024;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Alban Berisha - e kam cek dhe sot po e cek që duket shumë pikë e parëndësishme dhe vetëm më shumë është një raport obligim ligjor që thotë me sjell. Nuk e shoh një seriozitet edhe prej Kryetarit që është një pikë që duhet me u diskutu. Nuk po e shoh në raport të cekur se si ka shku festa e Vitit të Ri. Çdo raport po na ik si aktivitet. Si çdo vit që e kam cek, te mjetet piroteknike kontrolli është zero. Po miratohet pika por nuk po ndërmirren ato që po i flasim këtu. Nuk kam pa ndonjë raport se a ka pas lëndime prej mjeteve piroteknike, sa janë ndërmarrë masa mos me u shit në vendet jo adekuate. Këtu shkruan për takimin e parë: Informatë dhe diskutim për projektet e infrastrukturës dhe të shërbimeve që ndikojnë në sigurinë e qytetarëve. Unë nuk po shoh këtu se çka ka të bëjë me sigurinë e qytetarëve. Për trajtimin e qenve endacak s'kam çka të diskutoj sepse është temë e konsumuar. Projektet që dorëzohen nga anëtarët e KKS-së që ndërlidhen me çështjeve e sigurisë, Komuna ti merr parasysh dhe ti realizoj. Unë kisha pas dëshirë që informata të vjen pak më e detajuar, se cilat janë ato projekte. Vetëdijësimi i nxënësve për rrezikun nga minat dhe mjetet tjera të pa shpërthyer nga lufta. Është shumë e mirë seardhur kjo dhe mirë është që janë inkorporu forcat e FSK-së por në këtë raport fatkeqësisht askund nuk e pashë një pikë për vetëdijësimin e nxënësve për rrezikun nga duhani, alkooli dhe droga. Nëse një raport bëhet ku dalin rekomandime, jo çdo 6 muaj por çdo muaj duhet m'u kanë temë kjo. Jo vetëm juve si ekzekutiv por edhe e jona si Asamble dhe forcave në qytetet sepse është një dukuri që është duke ndodh dhe fatkeqësisht është duke u rrit me përmasa të mëdhaja. Janë mbajtë aktivitetet e maturës, a ka pas kontroll për alkool, a ka pas kontroll për lëndë narkotike? Thonë që është kompetencë e Qeverisë por është kompetencë e gjithë neve. Ju jeni pushteti që duhet me i kontrollu këto dhe e jona është me i denoncu. Për veq që s'ka kontroll, po u krijohen kushte për me i përdor këto. Policia të marrin masa të vazhdueshme për lëmoshë-kërkuesit, në veçanti për shtetasit e Republikës së Shqipërisë. Pak më pengon dhe kërkoj nga hartuesi i raportit që më mirë është me quajt për shtetasit e huaj sepse më duket e vrazhdë për një shtet amë që e kemi dhe kisha pas qef mos me pa në raport. Te përgaditja për mbrojtjen nga zjarri, cilat masa i keni marrë te zjarrëfikësat, a ka numër të mjtueshëm të zjarrëfikësve përveq vullnetarëve nëse ndodhin zjarre? A do të thotë që vetëm me ndërte një shesh mjafton apo ai shesh duhet me u kontrollu? A do të thotë p.sh. vijnë mërgimtarët dhe tash qyteti duhet me qenë katrahur, duhet me kqyr mos ka naj parking pa leje aty këtu dhe me i denu dhe tanë ditën dhe tanë natën boni çka të doni. Nuk është problem me i denu por problem është siguria në qytet. Unë gjithmonë kur po flas për KKS-në, e di që në fund përgjigja është që ne nuk jemi policia por në këtë këshill Kryetari është kryesues dhe duhet të futen këto rekomandime që po i them. Nuk po shoh nëpër udhëkryqa që ka polic dhe nuk është keq me bo vullnetar Kuvendi Komunal që me i orientu. E kam thënë dhe do ta them, merruni vesh me autobusa sepse janë duke e rreziku sigurinë publike.

Urim Suka - duke marr shkas nga seanca e kaluar ne kemi kërku nga Drejtori i Arsimit dhe Kryetari i Komunës që të bëhet një raport për organizimin që ka ndodh me maturanët. Këtë çështje e kemi ngrit edhe në KPF sepse në këtë shkresë që na ka ardhë te çështja e sigurisë dhe informatës nga KKS-ja, DKA në vazhden e aktiviteve që i ka parapa për maturanët, këtë aktivitate nuk e ka përmend fare. Për mua si asambleist kur një seancë kërkojmë një raport me na ardhë dhe pas një muaji ai raport nuk na vjen, është shqetësim kur ekzekutivi nuk i përgjigjet asambleistave dhe nuk e sjell atë raport edhe përkundër

zotimeve që i keni marrë që do ta adresoni dhe do të përpiqeni që me sjell atë raport për me diskutu. Në kuadër të organizimit që e ka bo Kryetari për maturanët, dua ta di: sa ka kushtu, kush i ka bërë ato pagesa, cila ka qenë siguria, çka kanë mujt me konsumu nxënësit aty dhe sa ka mujt m'u bërë dëm nga ajo që ka ndodh në atë aktivitet? Nëse raporti i specifikon dhe sqarohemi, në rregull jemi por të paktën mospërgjigjja dhe mosadresimi edhe në KKSB rrit dyshimet.

Pika 7. Raport nga DSHPJK për periudhën janar-qershor 2024 për çështjen e dhënies së pronave në shfrytëzim;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Liridon Fandaj - këtu është një raport vetëm për pronat që kanë me dal në ankand dhe nuk ka një raport për krejt pronat komunale që është edhe e gjetur e auditorit, me na njoftu se çka ka ndodh. A janë pagu rentat që i kanë ata dhe deri ku është procesi?

Kryetari - ne nuk e kemi ditë që përputhet me datën e njejtë, që vjen raporti i auditorit dhe vjen ky raport. Te renta është bërë një gabim të pasqyrat financiare sepse komuna nuk e tatimon pronën e vet, nëse është fajala për 22.000€.

Liridon Fandaj - kërkoja raport për pronat komunale që janë në shfrytëzim.

Armend Krasniqi - ne si drejtori e kemi paraqit një raport sipërfaqësor për ju në mënyrë që me zgju interes për çdo dyshim, problem të cilin e kemi si drejtori mirëpo ju me këtë raport jeni të kënaqur andaj nuk po shkoni më tutje. Sa i përket pyetjes, nuk është në drejtorinë time për me raportu për kontratat por është zyra ligjore e Kryetarit e cila duhet të raportojë për kontratat të të gjeturave të auditorit.

Liridon Fandaj - a është ky raport që e ka kërku auditori?

Armend Krasniqi - ky është raport i drejtorisë time në mënyrë që me zgju debat në interesa të qytetarëve.

Urim Suka - unë e kam përcjell punën dhe aktivitetin e drejtorit Krasniqi dhe në shumicën e rasteve m'u ka dok një drejtor deri diku i përgjegjshëm përkundër vështirësive dhe punëve që ka. Unë nuk pata qëllim me fol për këtë pikë për faktin që unë nuk jam shumë i përgaditur sot për këtë pikë. Ajo që tha drejtori më çudit dhe është një përgjegjësi e llojit të vet. Të lus që raportet kur i përgadit të jenë të qarta në detaje dhe ti parashohin të gjitha pronat për të cilat diskutohet dhe merren vendime në Asamble. Me sa kam informacion ka prona për të cilat ne kemi marrë vendime dhe ti nuk i ke sjell në këtë raport por tash unë do ta lë herën tjetër.

Armend Krasniqi - ta kam sjell raportin dhe po thua që nuk je i përgaditur për këtë raport. Je shef i asambleistave dhe si as një pyetje mos me bo në lidhje me një pikë!

Urim Suka - ta bëra pyetjen për të cilën nuk je tu dit as me m'dhënë informata. Ka prona që ne kemi marrë vendim e aty nuk figuron. Unë jam mirë i përgaditur por dua të jem 100% i përgaditur.

Armend Krasniqi - unë e kam sjell një raport dhe ti nuk e bërë asnjë pyetje lidhur me raportin. Kjo tregon nga ana juaj atë që ti nuk ke seriozitet dhe nuk ke një lloj përgjegjësie ndaj qytetarëve të cilët të kanë votu dhe të kanë sjell këtu.

Alban Berisha - për dallim nga kolega im, unë jam shumë i kënaqur por po më vje keq që nuk po mund të interferoj energjinë që ka edhe tek pjesa tjetër, duke nis prej kabinetit të Kryetarit dhe drejtorat tjerë. Të lus të shpërndash energji.

Pika 8. Pyetje dhe përgjigje;

Qëndrim Elshani - përshëndet të pranishmit. Shqetësimet janë të vazhdueshme për një rrugë të cilën e ka vizitu Kryetari para se m'u shtru. Këtë rrugë e kam përmend këtu mbi tre herë. Ka shumë rrugë të tilla. Rruga "Bubulina" nuk ka një muaj ose dy muaj që është shtru edhe pse mbi 1000 ditë me vonesë por prap nuk është shtru si duhet. Para 10 ditëve ka ra shi dhe banorët që jetojnë në atë lagje e kanë pa tmerrin prej atij shiu ku uji iu ka hy në shtëpi. Drejtori i Bujqësisë nuk është këtu. Ai seancën e kaluar ka premtu që do të dal dhe ta inspektoj gjendjen e rrugës. Si ti bëjmë zgjidhje banorëve të asaj lagje?

Visar Kuçi - unë jam marrë me rrugën “Bubulina”.Rruga “Bubulina” ka qenë me një kontratë të vitit 2020.Në mungesë të kanalizimit vet banorët e asaj lagje kanë kërku që rruga mos të shtrohet deri të kryhet kanalizimi.Ka fillu kontrata tjetër 2022 për rrugë lokale në Komunën e Suharekës dhe prap kanë dal banorët dhe kanë kërku të bëhet kanalizimi dhe kanë pas të drejtë.Me të njejtën kontratë pasi u realizu kanalizimi me kontratën e kanalizimeve është punu rruga “Bubulina” në standarte shumë të mira dhe jo segmenti i rrugës “Bubulina”,jo rrugë private.Tash mund të shkojmë dhe e shikojmë.

Qëndrim Elshani - unë kam shku personalisht e kam pa dhe e kam edhe videon.Sot mund të shkojmë.

Visar Kuçi - rruga Bubulina është punu në standarte të mira dhe është ende e pa pranuar teknikisht.

Ka pas televizione vitin e kaluar dhe ka dal një banor ka fol aty edhe pse nuk është banor i asaj lagje.

Qëndrim Elshani - nuk është esenca me bo politikë por esenca është ti bëhet zgjidhje qytetarit.

Urim Suka - ditëve të fundit unë isha në fshatin Javor dhe banorët atje thanë që ka 20 vite që asnjë metër kanalizim nuk është shtru.Më vjen turp sepse një pjesë të këtyre viteve ka qenë edhe përgjegjësi e jona por kur ka qenë përgjegjësia jonë më herët investime ka pas shumë pa bërë dhe ndoshta kanë pas arsyen e vet,edhe pse nuk justifikohet.Ndërsa tash sa vite ju jeni,as një meter kanalizim nuk është bë.

Ju kisha lut që nesër të shkoni në atë vendbanim,ta shikoni gjendjen dhe të provoni me intervenu.Përkundër kësaj ju keni qenë të informuar,keni pas kërkesa të kryesive të fshatit.Dua ta përmend një pjesë të kanalizimit në fshatin Bllacë në lagjen Zekolli ku unë isha atje me kërkesën e qytetarëve. Ish një kohë që ishin të bllokuar tre shakta dhe ka shumë probleme në vazhdimësi dhe në këto temperatura të larta ujërat e zeza po i kalojshin në shtëpi.Ekziston kontrata dhe ju lutem intervenoni dhe shkoni e shikone gjendjen.Kërkesë për Drejtorinë e Kulturës.Unë e kam kërku një raport për mënyrën se si janë dhënë subvencionet dhe Drejtoresha e Kulturës e ka sjell dhe e falemderoj.Sot kërkoj një raport të pranimit të atyre punëve se sa janë realizu ato aktivitete dhe a është marrë ndonjë përgjegjësi për ata që i kanë marrë parat dhe nuk i kanë realizu aktivitetet?Nuk dua të paragjykoj sepse ndoshta të gjitha janë realizu mirë por unë e kam marrë një informatë më herët për një libër që janë dhënë paratë e ajo libër nuk është botu.Shqetësim tjetër është që unë e kam marrë një letër prej Erëlesa Krasniqit dhe më kanë thënë që këtë letër e kanë marrë të gjitha grupet parlamentare.Erëlesa Krasniqi është një vajzë për të cilën është debatuar në seancën e kaluar për mostrajtimin e duhur në QKMF.Kur ajo e ka pa diskutimin,ajo është ndier e shqetësuar dhe e fyer sepse drejtimi ka shku që ajo i ka fajet për atë që ka ndodh dhe sipas sqarimit që ajo bën,unë e inkurajoj dhe e falemderoj për këtë letër që e ka asjell dhe e inkurajoj secilin që ka ndonjë shqetësim ta adresoj sepse në fund ky është vendi ku adresohen çështjet.Dua të di nëse Drejtoresha ka marrë informatat e nevojshme dhe ka marrë vendimet e duhura për këtë rast dhe të sqaroj për këtë rast.Qëllimi i këtij diskutimi është që shërbimet ku do që bëhen,me shku sa ma mirë për qytetarët.

Kryetari - te kanalizimi në fshatin Javor ke plotësisht të drejtë.Me një kompani kemi probleme,lëndën e kemi në gjykatë.Procedurat e reja që fillojnë hyn Javori.Te lagjia e Zekollëve ke të drejtë por në qoftëse është një kompani shtetërore që çdo kush prej nesh paguajmë nga 3 euro taksë çdo muaj për mirëmbajtje në kanalizim.Ne mund të shkojmë prej zeros me atë kanalizim por përndryshe është obligim i Hidroregjionit sepse e ka detyrë pastrimin.Te pyetja e tretë,është dikush tjetër duke u marrë me atë lëndë dhe le të përfundon lënda dhe ta shohim se ku jemi ne si ekzekutiv dhe ku është QKMF-ja.

Besa Kuçi - ajo e ka bë një ankesë në këshillin e QKMF-së te menaxhmenti i QKMF-së.Përgjigjen e ankesës e ka marrë Erlesa Krasniqi dhe nëse ajo e ndien që u trajtu në mënyrë jo profesionale ose ka shqetësime tjera atëherë janë organet tjera kompetente mirëpo atë përgjigje e ka marrë nga profesionistët dhe unë ju ftoj juve dhe qytetarët që ti besoni profesionistëve në këtë drejtim.Me sa e shohim nuk ka as një dëm dhe është doktorri këtu për me na sqaru më detaisht.Secili qytetar që bën ankesë dhe që e adreson te ju ankesat,duhet me prit që ka me u bë debat mirëpo ne nuk kemi bë ndonjë debat që është jasht kornizave.Siç tha edhe Kryetari unë i përgëzoj satfin e QKMF-së sepse me të vërtetë janë duke e bërë një punë të mirë.

Urim Suka - Kryetari në përgjigjen që dha për kanalizimin në Javor tha: ke të drejtë.Unë vetëm po pres që të ndodh investimi atje brenda asaj kohe kur ti e liron pasi e paske me probleme.Kryetari më pyeti për lagjen e Zekollëve se a kanë ujë.Ata kanë bë instalime më herët por ujë nuk paguajnë pasi ata nuk janë duke u furnizu me ujë qe një kohë të gjatë aq sa di unë por gjendja është e rëndë dhe është mirë t'i dilni në

ndihmë. Te pjesa që u diskutu me Erlesën, unë e kam marrë një letër si ju krejt dhe unë dashta me qu në vend atë mesazh të Erëlesës dhe nuk jam duke e fajsu askënd sepse e di çka ndodh në QKMF dhe sa vështirësi kanë ata. Por kur jemi në detyrë zyrtare duhet me ditë me prit edhe atë që bërtet, edhe atë që vjen me sëmundje. Mbështetje për punën që po e bëjnë sidomos në këto temperature.

Aziz Bytyqi - respekt maksimal për mjekët të cilët bëjnë punë me përkushtim por edhe mjekët janë njerëz si ne dhe ata mund të gabojnë. Kur është diskutu kjo çështje nuk kam pas asnjë informacion. Kur ka përfunduar seanca, pas dy dite më ka thirr ajo vajza. Jam taku me vajzën dhe babain e saj sepse e njoh, kemi bisedu dhe ajo e din shumë mirë që për atë që është fol është lexu gabim sepse ia kam sqaru. Barnat shkruhen me dorëshkrim dhe dorëshkrimi mund edhe të mos lexohet saktë. Ata e kanë kuptu që në bazë të debatit këtu dol ai si një lloj fabrikimi, si lloj tendence që e ka bo ajo vajza por kjo mund të ndodh për shkak të mungesave të informacionit sepse unë jam i bindur që Destan Krasniqi kurr nuk fabrikon asgjë. Ai është ish ushtari më i ri i Kitrave, nipi i të mirënjohurit Sali Kelmendi i cili është njëri ndër humanistat më të mëdhaj në komunën tonë 100 vitet e fundit edhe ata e kanë kuptu që s'ka pas tendencë.

Shefket Kolgeci - kjo temë mbledhjen e kaluar ishte shumë e acaruar dhe debate secili në këndvështrimin e vet jep. Unë që 36 vjet jam mjek dhe kur të vje pacienti dhe ka nevojë për barna, e para pyetje që i bëhet pacientit është : a je alergji në barna? Shefket Kolgeci jep sqarime sa i përket alergjisë në barna dhe thotë që kjo mund ti ndodh edhe ekspertave më të mëdhenjë në botë me një alergji. Barin që e ka shkru mjeku dhe që ka thënë pacienti është për kafshë, kjo është e papranueshme. Gabimi është i farmacistit. Mjeku mund të gaboj në doze por jo këtu. Me rëndësi është që pacienti nuk ka pësuar.

Aziz Bytyqi - ajo është kthye te i njejt mjek pas 10 minutash dhe i ka thënë që ilaqui më duket i dyshimtë pastaj mjeku a ka thënë që gabim e ka lexu farmacistja dhe ajo as që e ka përdor atë ilaç.

Elmaze Bytyqi - pyetje për Drejtorin e Arsimit: Pse ende nuk po lëshohet në shfrytëzim qerdhja e qytetit ku me sa kam informacion ajo qerdhe ka pas me u lëshu në qershor?

Remzi Bajselmani - është shqetësim me vend. Nuk kemi kompetencë por është në kompetencë të ministrisë. Ne jemi përpjek maksimalisht që kjo çështje të zgjidhet. Tani është duke u bërë inventarizimi dhe shpresoj shumë që në shtator do të përgaditet qerdhja.

Selman Kolgeci - pyetje për drejtor Shabanin lidhur me ndriçimin publik në fshatin Mushtisht. Kanë bërë një kërkesë për zgjerimin e rrjetit të ndriçimit publik në Mushtisht por nuk iu kanë përgjigj. A mund të na sqarosh se pse nuk është zgjeru dhe kur pritet të zgjerohet rrjeti i ndriçimit publik aty?

Enver Shabani - unë personalisht nuk di që ka ardhë ndonjë kërkesë nga fshati Mushtisht për zgjerimin e rrjetit por përgjigjen e marrin brenda 30 dite dhe nuk do të thotë që çdo kërkesë që vje merr përgjigje pozitive për zgjerim sepse ajo varet nga projektet që bëhen sepse jo të gjithë fshatrat janë të mbuluar 100% por kjo vjen hap pas hapi.

Selman Kolgeci - unë e kam një kërkesë që e ka bërë kryetari i fshatit Mushtisht e datës 03.05.2024.

Enver Shabani - ndoshta ka bërë kërkesë ose planifikim 1 vjeçar. Çdo kryetar i fshatit e ka obligim me mbush një formular për prioritetet e fshatit të vet dhe jo të gjitha prioritetet i lexojmë një nga një por kjo mund të ndodh në shtator kur të bëhet aprovimi i buxhetit dhe mund të hyjë edhe zgjerimi i ndriçimit në Mushtisht.

Shefket Kolgeci - rruga e proritit që e keni në program, a keni bo ndonjë projekt, a e keni bërë murin dhe a do të kryhet këtë vit apo vitin e ardhshëm?

Kryetari - u krye muri edhe rruga. Punimet kanë fillu në Vraniq dhe i kemi disa probleme pronësore dhe i kisha lut në mënyrë publike dy asambleistat me dal dhe me i zgjidh ato probleme.

Selman Kolgeci - është e vërtetë që është krye rruga dhe muri mbrojtës mirëpo është keqpërdor qytetari në një formë që ju ka thënë: hajde merrni sa t'ju duhet pronë dhe nuk keni nevojë me kompenzu. Ju keni shku dhe e keni vendos murin 1 metër ma large, pra ia keni marrë 1 metër për një gjatësi 20 metra pa asnjë arsye.